



Fillime të Qëndrueshme:

*- Përkrahja e zhvillimit emocional në Edukimin e
Fëmijërisë së Hershme në Kosovë*

Gusht, 2025

Artikulli 2: Fillime të Qëndrueshme

- Përkrahja e zhvillimit emocional në Edukimin e Fëmijërisë së Hershme në Kosovë

Nisma “CHAVORE” synon të sigurojë mirëqenien mendore dhe fizike të çdo fëmije, pavarësisht prejardhjes së tij, që nga fillimi. Në komunitetet ku fëmijët përballen me vështirësi, stigmatizim ose përjashtim, ”CHAVORE” përkrah profesionistët e fëmijërisë së hershme dhe prindërit për t’u përgjigjur më mirë nevojave psikologjike, emocionale dhe të rritjes së fëmijëve, përmes praktikave gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj diversitetit.



Në Kosovë, kjo punë po udhëhiqet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), një nga partnerët lokalë zbatues të CHAVORE. Si një organizatë e shoqërisë civile e njohur për rolin e saj në inovacionin arsimor, avokimin e politikave dhe trajnimin e mësimdhënësve, KEC, e themeluar në vitin 2000, ka ndërtuar një reputacion të mirë për përshtatjen e praktikave më të mira globale me kontekstin unik kulturor dhe pas-konfliktual të Kosovës

Në kuadër të CHAVORE, KEC ka zhvilluar një modul trajnimi të fokusuar në **zhvillimin e aftësive** për shprehjen dhe **kuptimin e emocioneve**, si dhe të **përshtatshmërisë** tek fëmijët e vegjël. Duke krijuar ndërveprime mbështetëse,



respektuese dhe të përshtatura me kontekstin kulturor, ky modul synon t'u ndihmojë fëmijëve që ta zhvillojnë vetëbesimin, vetëvlerësimin dhe sigurinë emocionale – gurthemel i të nxënit gjatë gjithë jetës, shëndetit mendor dhe mirëqenies së tyre.

Një sfidë kryesore gjatë fazës së hartimit ishte **mungesa e materialeve** vendore mbi zhvillimin emocional dhe përshtatshmërinë. Për ta adresuar këtë, KEC përshtati mjete si metoda “Persona Doll” dhe teknikat e ndërgjegjësimit, për ta pasqyruar më mirë realitetin e përditshëm të fëmijëve dhe profesionistëve në Kosovë. Me rëndësi, moduli u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me edukatorët që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët e vegjël.

Në thelb, moduli i trajnimit përcjell një mesazh të thjeshtë, por transformues: **siguria emocionale 🧡 dhe besimi ndërtohen përmes ndërveprimeve të përditshme**. Profesionistët inkurajohen të vëzhgojnë dhe t'u përgjigjen emocioneve të fëmijëve me ngrohtësi dhe qëllim, duke përdorur praktika si diskutimet në rrethin e mëngjesit dhe reflektimi përmes lojës, për ta mbështetur zhvillimin e strategjive të përballjes me sfidat.

Për ta vlerësuar efektivitetin e të mësuarit të vetë-drejtuar, KEC mbështetet në reflektimet e profesionistëve, ndryshimet e dukshme në sjelljen e fëmijëve dhe dialogun e udhëhequr nga vetë fëmijët - të gjitha këto të bazuara në bindjen se përshtatshmëria zhvillohet në kontekstin e marrëdhënieve me ndjenjë sigurie dhe kujdesi.

CHAVORE (që do të thotë “fëmijë” në gjuhën rome) është një iniciativë që synon të përmirësojë shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve të vegjël, veçanërisht atyre nga komunitetet e cënueshme, si familjet rome. Ajo promovon gjithëpërfshirjen dhe kujdesin për fëmijërinë e hershme, të ndërtuar me ndjeshmëri ndaj diversitetit kulturor, në pesë vende. E bazuar në ekspertizën e [International Step by Step Association](#) dhe iniciativës së saj [Romani Early Years Network \(REYN\) initiative](#), CHAVORE shfrytëzon një partneritet transnacional për të zhvilluar arsim dhe kujdes gjithëpërfshirës e të përgjegjshëm në fëmijërinë e hershme.

E financuar nga [European Commission](#), konsorciumi përbëhet nga anëtarët e ISSA-së, i udhëhequr nga [Educational Research Institute](#) (Slloveni), dhe përfshin [Open Academy Step by Step](#) (OASbS), [Partners Hungary Foundation](#) (PH), [Skola dokoran - Wide Open School](#) (SD), [Kosovo Education Center](#) (KEC), dhe [ISSAHub](#).

Mësoni më shumë në: chavore.reyn.eu



Funded by
the European Union



ROMANI
EARLY YEARS
NETWORK

CHAVORE PARTNERS



25⁺ years for
Early Childhood
Development